



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 17, dt. 30.10.2023

**“PËR PJESËMARRJEN E KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË NË PROJEKTET
NDËRKUFITARE /NDËRKOMBËTARE”**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 9, 14, 34 dhe 37, Ligjin Nr. 43/2016 Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, Ligjin Nr. 37/2015 Për Ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për Rregullat e Zbatimit të Mbështetjes Financiare të Be-Së për Shqipërinë, në Kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), Ligjin Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023, Udhëzimin Nr. 9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” Udhëzimin plotësues Nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Udhëzimin Nr. 35 datë 21.09.2020 Për Kontrollin, Rregjistrimin, Përdorimin, Rakordimin dhe Publikimin e Fondeve të Huaja në Kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare, i ndryshuar (2023) Udhëzimin Nr. 22 dt. 10.07.2013 Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit,

VENDOSI

- Të autorizojë pjesëmarrjen e Këshillit të Qarkut Korçë në programet ndërkufitare/ndërkombëtare dhe në të gjitha thirrjet për projekte të lancuara nga Bashkimi Europian, Asambleja Europiane e Rajoneve, ARLEM etj.
- Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut Korçë për përfaqësimin institucional në mbledhje dhe takime me Organizata Ndërkombëtare si ARLEM, AER, Komitetet e Monitorimit për programet Ndërkufitare/Ndërkombëtare etj, ku Këshilli i Qarkut aderon por edhe në takime të tjera ku do të ftohet të marrë pjesë.
- Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut të lidhë kontrata, marrëveshje bashkëpunimi dhe binjakëzime etj. në kuadër të këtyre programeve, si dhe të informojë Këshillin e Qarkut për aplikimet, fondet e vendosura në dispozicion, ligjshëmërine dhe manualin e zbatimit në kuadër të këtyre thirrjeve.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kabineti i Kryetarit, Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT TË QARKUT

ERJON NEXHIPI

Koncept. Kesh. per Projektet e BE: M. Alickolli
Kesh. juridik: Gj. Kristo
Sek i Këshillit: B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

“MBI PJESËMARRJEN E KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË NË PROJEKTET
NDËRKUFITARE /NDËRKOMBËTARE”

I. QËLLIMI I VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij Vendimi është realizimi i Pjesëmarrjes së Këshillit të Qarkut Korçë në Projektet Ndërkufitare /Ndërkombëtare” bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 9, 14, 34 dhe 37, të Ligjit Nr. 43/2016 Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, Ligjin Nr. 37/2015 Për Ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për Rregullat e Zbatimit të Mbështetjes Financiare të Be-së për Shqipërinë, në Kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).

Hartimi dhe miratimi i këtij Vendimi synon të mbështesë Kuadrin Strategjik mbi të cilin ngrihen dhe zbatohen politikat dhe proceset për një menaxhim me efektivitet dhe eficiensë të ndihmës së Huaj e cila synon të sigurojë koherencën, efektivitetin dhe harmonizimin në planifikimin strategjik, në financat publike dhe monitorimin e politikave rajonale. Në mënyrë më specifike, garanton koherencën ndërmjet Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2016-2020 (SKZHIE II), Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030 (SKZHIE III), Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) - Afatgjatë dhe strategjise rajonale.

II. VLERËSIMI I VENDIMIT

Vendimi është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) me definicion “Bashkëfinancim me fondet e BE” ku janë përcaktuar vizioni dhe prioritetet strategjike të zhvillimit rajonal të harmonizuar me objektivat e programit IPA CBC GREQI – SHQIPERI 2021-2027 që sintetizon qëllimet, politikat dhe prioritetet e strategjive sektoriale rajonale.

III. ARGUMENTIMI I VENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

a. PROGRAMI INTERREG IPA CBC GREQI – SHQIPËRI 2014 -2020

Këshilli i Qarkut Korçë zbatoi në periudhën 2014 -2020 me sukses projektet me impakt të fortë rajonal si më poshtë:

- SAVE WATER – MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE / STRATEGJIK;
- WASTE RREACT – MENAXHIMI INTEGRUAR I MBETJEVE/ STRATEGJIK;
- WINCOME – AGRO BIZNES/ SOFT - DIXHITALIZIMI PILOT I ZONAVE KULTIVUESE TE VERAVE, HARTEZIMI & KATALOGIMI PRODUKTIT;
- SAVESAFEWATER - MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE / SOFT;
- CLLD CULTOUR – TURIZËM – RRUGA TURISTIKE KULTURORE / SOFT;

b. PROGRAMI INTERREG IPA CBC GREQI – SHQIPËRI 2021-2027

Hartimi i programit të një projekt propozimi bazohet në strategjinë e zhvillimit të rajonit ku përcaktohen përparësitë dhe objektivat strategjike. Më pas vijohet me përgatitjen sipas këtyre fazave (i) Identifikim i nevojës; (ii) përgatitja e projekt-idesë; (iii) konsultimi dhe miratimi në parim (iv) negociatat dhe miratimi final;

Për programin e ri INTERREG IPA CBC GREQI – SHQIPËRI 2021-2027:

Prioritetet kryesore të thirrjes mbështeten në:

- Axhenda e Gjelbër / Për Një rajon më të gjelbër dhe më elastik ndërkufitar Greqi-Shqipëri;
- E aksesueshme / Për Një rajon ndërkufitar lehtësisht të aksesueshëm Greqi-Shqipëri;
- Sociale / Një rajon ndërkufitar i qëndrueshëm ekonomikisht dhe social Greqi-Shqipëri;

Objektivat e thirrjes :

- RSO2.4. Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë çukuritë natyrore etj, duke marrë parasysh qasjet e bazuara në ekosistem;
- RSO2.5. Promovimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore;
- RSO3.2. Zhvillimi dhe përmirësimi i lëvizshmërisë kombëtare, rajonale dhe lokale duke përfshirë aksesin e përmirësuar në infrastrukturën rrugore (TEN-T) dhe lëvizshmërinë ndërkufitare.
- RSO4.5. Sigurimi i aksesit të barabartë në kujdesin shëndetësor dhe nxitja e qëndrueshmërisë së sistemeve shëndetësore, përfshirë kujdesin parësor, dhe promovimi i kalimit nga kujdesi institucional në kujdesin e bazuar në familje dhe komunitet.

- RSO4.6. Rritja e rolit të kulturës dhe turizmit të qëndrueshëm në zhvillimin ekonomik, përfshirjen dhe risitë sociale.

Pjesëmarrja në Organizata ndërkombëtare AER, ARLEM, binjakëzime, marrëveshje bashkëpunimi etj ku aktorët rajonalë promovojnë rajonin brenda rrjetit të qëndrueshëm rajonal evropian, përmirësimi i politikave rajonale, shkëmbimi i përvojave duke ndarë praktikat dhe duke ofruar rritje kapacitetesh është qasja jonë në këto partneritete.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Vendimi është hartuar në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 9, 14, 34 dhe 37, Ligjin Nr. 43/2016 Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, Ligjin Nr. 37/2015 Për Ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për Rregullat e Zbatimit të Mbështetjes Financiare të Be-Së për Shqipërinë, në Kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), Ligjin Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023, Udhëzimin Nr. 9 datë 20.03.2013, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” Udhëzimin plotësues Nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Udhëzimin Nr. 35 datë 21.09.2020 “Për Kontrollin, Rregjistrimin, Përdorimin, Rakordimin dhe Publikimin e Fondeve të Huaja në Kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”, i ndryshuar (2023) Udhëzimin Nr. 22 dt. 10.07.2013 Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË VENDIMIT

Vendimi është i organizuar në 3 pika si më poshtë:

- **Në pikat 1-2** parashikohet e drejta e pjesëmarrjes së Këshillit të Qarkut Korçë në programet ndërkufitare/ndërkombëtare, nëpërmjet përfaqësimit nga Kryetari i Këshillit të Qarkut në mbledhje dhe takime me Organizata Ndërkombëtare, në Komitetet e Monitorimit për programet Ndërkufitare/Ndërkombëtare si dhe në të gjitha thirrjet për projekte të lancuara nga Bashkimi Europian, Asambleja Europiane e Rajoneve, ARLEM etj.
- **Në pikën 3** parashikohet autorizimi i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë për të lidhur kontrata, marrëveshje bashkëpunimi dhe binjakëzime etj, në kuadër të këtyre programeve, si dhe të informojë Këshillin e Qarkut për aplikimet, fondet e vendosura në dispozicion, ligjshmërinë dhe manualin e zbatimit në kuadër të këtyre thirrjeve.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi është Këshilli i Qarkut Korçë, konkretisht Kabineti i Kryetarit dhe Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E VENDIMIT

Vendimi është hartuar nga një grup pune në Këshillin e Qarkut Korçë dhe është mbështetur në praktikat më të mira të vendeve tjera të rajonit.

II. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Hyrja në fuqi e këtij vendimi nuk shoqërohet me efekt financiar për buxhetin e shtetit.

Koncept. Kësh. për Projektet e BE: **M. Aličkoll**

KABINETI I KRYETARIT



KRYETAR I KËSHILLIT TË QARKUT

ERJON NEXHIPI

